

URDHËR
Nr. 70, datë 13.5.2013

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN E SKEMËS SË PËRBASHKËT TË
TARIFAVE PËR SHËRBIMET E LUNDRIMIT AJROR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 8821, datë 15.10.2001 për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën e Eurocontrol-it, ligjit nr. 9658, datë 18.12.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe midis Komunitetit European dhe Shteteve Anëtare, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Islandës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Serbisë, Republikës së Malit të Zi, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë dhe Misionit Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, mbi krijimin e një zone të përbashkët europiane të aviacionit” dhe në zbatim të neneve 85, 86, 87 të ligjit nr. 10 040, datë 22.12.2008 “Për Kodin Ajror të RSH-së”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores për “Përcaktimin e skemës së përbashkët të tarifave për shërbimet e lundrimit ajror”, sipas tekstit dhe shtojcave që i bashkëlidhen këtij urdhri.
2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij urdhri.
Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi